

STATUT



I

SHOQERISE ANONIME "SIGURIA E MADHE" SH.A ("SIGMA" SH.A)

KAPITULLI I

FORMA, EMERTIMI, SELIA DHE OBJEKTI

Neni 1.

Forma juridike

Shoqeria themelohet ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe do te funksionoje ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te ligjit Nr.8081 date 7.03.1996 "Per veprimtarite e sigurimit dhe risigurimit" dhe sipas ketij statuti e aktit te themelimit.

Neni 2

Emertimi

Emertimi i plote i shoqerise eshte "SIGURI E MADHE" Sh.A dhe emertimi i shkurtuar i saj do te jete "SIGMA." Sh.a
Shoqeria ka stemen dhe vulen zyrtare te saj.


Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e dala nga shoqeria te destinuar per te tretet tregohet emertimi i plote i shoqerise si dhe adresa e selise te saj.

Neni 3

Selia dhe rrjeti

Selia e shoqerise eshte ne Tirane Rruga "SHESHI WILSON" 3- katës Nr 101A

Shoqeris ka rjetin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise perbere nga dege, dhe zyra te sherbimeve qe ofron shoqeria ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj



Neni 4

Kohezgjitja

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtari ne peruthje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete statut per nje afat kohor te pacaktuar.

Neni 5

Objekti.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj sigurimin ndaj demeve dhe risigurimet, ne peruthje me ligjin Nr.8081, date 7.03.1996 "Per sigurimet dhe risigurimet", si dhe cdo objekt tjeter veprimtarie te lejuar nga legjislacioni ne fuqi dhe qe nuk vjen ne kundershtrim me ligjin e mesiperme dhe me rregullat e percaktuara per kete qellim nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sgurimeve.

Shoqeria nuk do te kryeje veprimtari persa i perket sigurimit te jetes.

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page, including a date stamp "28 radoni 98" and a signature "Stojan".

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 30.000.000 (tridhjetemilion) leke.

Ai eshte i ndare ne 30.000 (tridhjetemije) aksione nominative te themeluesve te shoqerise te cilet jane te se njejtës kategori me vlere nominale prej 1.000 (njemije) leke per çdo aksion.

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri ne 30.000 perfshire numrin e fundit te aksionit.

Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si me poshte:

Emri Mbiemri	perqindja	Nr. I aksioneve	Vlera ne leke
1. Behar Shehu	24 %	7.200	7.200.000
2. Shpetim Prodani	21 %	6.300	6.300.000
3. Dod Doçi	21 %	6.300	6.300.000
4. Thanas Kostaqi	10 %	3.000	3.000.000
5. Fatmir Thana	8%	2.400	2.400.000
6. Hysen Tepelena	4 %	1.200	1.200.000
7. Idajet Kuka	4 %	1.200	1.200.000
8. Vladimir Burill	3 %	900	900.000
9. Madlena Xhara	3 %	900	900.000
10. Lavdi Avllaj	2 %	600	600.000

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page, including a circular stamp on the left and several signatures, some with dates like '18.05.98' and '18.05.98'.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te kryhet vetem me vendim te asamblese te jashtezakonshme te aksionereve, ne baze te raportit te keshillit mbikqyres, i cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perparise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte perpjestimore me shumen e aksioneve te zoteruara nga secili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.


Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata munden gjithashtu te kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestuesmerise, por me kusht qe asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete.

Neni 8

Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise kryhet vetem me vendim te asamblese te pergjithshme te jashtezakonshme te aksionereve dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 164 deri 166 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Zvogelimi i kapitalit themeltar nepermjet riblerjes te aksioneve ose te shperndarjes te mjeteve rezerve mund te vendoset vetem pasi te jete marre paraprakisht autorizimi me shkrim nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. The signatures are in black ink and appear to be official or personal signatures. There are several distinct signatures, some with dates like '1998' and '1999' visible. There are also some stamps or official markings, including one that looks like 'Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve'.

Shoqeria nuk mund te beje shperndarje kapitali neqoftese sipas legjislacionit ne fuqi, pas shperndarjes se saj do t'i mbetet me pak se kapitali minimum i detyrueshem.

Neni 9

Shlyerja e aksioneve

Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen te pakten 50 per qind te vleres se tyre qe ne momentin e nenshkrimit.

Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me nje ose disa keste ne baze te kerkimit per shlyerje nga keshilli i drejtuesve ne nje afat kohor ne peruthje me rregullat e licensimit nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme qe vendos zmadhimin e kapitalit ka te drejte te marre nje vendim per shlyerjen teresore te aksioneve qysh ne momentin e nenshkrimit ose brenda nje afati me te shkurter nga ai i permendur ne paragrafin e dyte te ketij neni.


Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkrueseve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per çdo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar çdo titullari te aksioneve.

Çdo vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave sipas perqindjeve ligjore duke filluar nga data e kerkimit te cdo derdhje pa qene nevoja per te proceduar ne formalitete te tjera te ç'faredoshme dhe pa hequr dore nga veprimet e shoqerise ndaj aksionerit detyrues dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga ligji.

Neni 10.

Forma e aksioneve

Aksionet e shoqerise jane te formes nominative.



The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are two overlapping signatures. In the center, there is a circular stamp with some illegible text. To the right of the stamp, there are two more signatures, one of which appears to be 'Shoqëria' with the number '5' below it. The signatures are written in black ink on a white background.

Pronesia e aksioneve vertetohet nga regjistrimi i tyre ne emer te pronarit ne regjistrin e mbajtur per kete qellim nga shoqeria, ne kushtet dhe sipas menyrave te parashikuara nga ligji.

Shoqeria i leshon atij nje vertetim te regjistrimit te aksioneve ne pronesi te tij.

Neni 11.

Shitja dhe transferimi i aksioneve.

Sa kohe qe shoqeria do te jete pa oferte publike, pervec rastit te trashegimise transferimi i pronesise mbi aksionet nje personi joaksionar, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet nga keshilli i mbikqyres ne kushtet dhe sipas procedurave te parashikuara nga neni 207 i ligjit per shoqerite tregtare.

Neqoftese keshilli mbikqyres ka refuzuar shitjen e aksioneve nje blesesi te dhene joaksioner, brenda tete diteve nga data e njoftimit te refuzimit, shitesi duhet te njoftoje shoqerine me leter rekomande ne se ka hequr dorë apo jo nga projekti i shitjes se aksioneve.

Neqoftese per vleresimin e aksioneve ka vend per ekspertize shpenzimet per kete perballohen per gjysme nga shitesi dhe per gjysme nga blesesi.

Neni 12

Pandashmeria e aksioneve

Aksionet jane te pandashme per kundrejt shoqerise.

Bashkepronaret e aksioneve jane te detyruar te paraqiten para shoqerise, nga njeri prej tyre, i konsideruar si pronar i vetem, ose nga nje perfqesues i vetem i zgjedhur nga bashkepronaret. Ne rast mosmarreshje perfqesuesi mund te caktohet nga gjykata me kerkesen e bashkepronarit qe e merr i pari kete nisme.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. One signature is clearly legible as "Saradani 98". There are several other illegible signatures and a stamp with the number "6".

Neni 13

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

Çdo aksion jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndashme vjetore te shoqerise dhe ne tepricen e aktivitet te mbetur ne rastin e nje likuidimi, ne nje pjese perpjestimore me kuoten e kapitalit qe perfaqeson aksioni.

Pervec kesaj ai jep te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblete e pergjithshme ne kushtet ligjore dhe statutore.

Aksioneret jane pergjegjies per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te aksioneve qe zoterojne. Çdo kerkim i fondeve pertej kesaj shume eshte i ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionin e ndjekin kete aksion ne çfaredo dore qe ai kalon.

Pronesia e nje aksioni permban automatikisht te drejten e adimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese se pergjithshme.

KAPITULLI III

DREJTIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Seksioni 1 Keshilli i Mbikqyres

Neni 14.

Perberja dhe emerimi

Drejtohet nga nje keshill drejtuesish qe perbehet nga 3 anetare, me rezerven e shmangieve te parashikuara nga ligji per rastet e bashkimit me nje shoqeri tjeter. Anetaret e pare te keshillit mbikqyres jane:

[Handwritten signatures]

[Handwritten signature]

[Handwritten signatures]

- | | |
|------------------|---------|
| 1. Dod Doçi | Kryetar |
| 2. Fatmir Thana | Anetar |
| 3. Xhemali Shehu | Anetar |

Antaret e keshillit te Mbikqyres emerohen nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve per nje kohe prej 2 vjet. Ne emerimin e anetareve te Keshillit te Mbikqyrjes respektohen papajtueshmerite apo ndalesat ligjore.

Funksionet e anetareve te keshillit te mbikqyres perfundojne normalisht ne mbarim te mbledhjes se pergjithshme te aksionereve qe vendos per llogarite e ushtrimit te mbyllur e mbajtur ne vitin gjate te cilit mbaron mandati i tyre.

Antaret e keshillit mbikqyres jane te rizgjedhshem.

Ata mund te shkarkohen ne çdo kohe nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve.

Neni 15.

Person juridik anetar i keshillit te drejtuesve

Nje person juridik qe eshte aksioner i shoqerise mund te jete anetar i keshillit mbikqyres. Ne kete rast ky duhet te caktoje, qysh ne çastin e zgjedhjes, nje perfaqesues te perhershem person fizik, i cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrime dhe ka te njejtat pergjegjesi civile e penale sikur te ishte ai vete anetar i keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjesia e perbashket personin juridik qe ai perfaqeson.

Neqoftese personi juridik ia heq mandatin perfaqesuesit te tij duhet te njoftoje per kete shoqerinemenejhere dhe te beje njekohesisht zvendesimin e tij. Ky rregull do te zbatohet edhe ne rastet e vdekjes, te doreheqjes ose te pengimeve te zgjatura te perfaqesuesit te perhershem.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are three signatures. In the center, there is a signature and a stamp that reads "Sh. R. 98". To the right, there is another signature and a stamp that reads "8".

Neni 16.

Vendet bosh ne keshillin e mbikqyries

Neqoftese nje ose disa vende ne keshillin mbikqyres mbeten bosh midis dy mbledhjeve te pergjithshme te aksionereve, si rrjedhoje e vdekjes apo doreheqjes, keshilli mund te beje nje ose disa emerime te perkoheshme.

Emerimi i anetareve nga vete keshilli duhet te ratifikohet nga mbledhja e pergjithshme me e afert e aksionereve. Ne rastin kur mbledhja e pergjithshme e aksionereve nuk ratifikon anetaret e emeruar nga keshilli vendimet e marra me pare nga keshilli mbeten gjithmone te vlefshme.

Neni 17.

Kryetari i keshillit

Kryetari i Keshillit Mbikqyres emerohet nga asambleja e pergjithshme e aksionereve, midis anetareve te tij dhe ngarkohet te mbledhe keshillin dhe te drejtoje debatet gjate seancave te tij.

Kryetari i keshillit mbikqyres eshte detyrimisht persona fizike dhe nuk mund te zgjidhen ndermjet perfaqesuesve te personave juridike.

Ai i ushtron funksionet e tij gjate tere periudhes se mandatit si anetare te keshillit te drejtuesve.

Keshilli Mbikqyres mund te emeroje, gjithashtu, nje sekretar qofte edhe jashte anetareve te tij, duke caktuar edhe kohezgatjen e funksioneve te ketij.

Kryetari i keshillit dhe sekretari jane te rizgjedhshem.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are three distinct signatures. In the center, there is a stamp that appears to be a date or a reference number, possibly '1998'. To the right of the stamp, there are more signatures, including one that looks like 'Stojanov'. At the bottom right, there is a large, stylized signature or mark.

Neni 18.

Mbledhjet e keshillit te mbikqyrjes

Keshilli i Mbikqyres eshte organ kolegjal; pergjegjes, dhe mbikeqyres per shoqerine. Ai ben shqyrtim dhe merr vendime vetem nepermjet mbledhjeve te tij.

Keshilli i mbikqyrjes mblidhet nje here ne tre muaj dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise. Ai mblidhet gjithashtu ne fund te çdo tremujori per te degjuar raportin e drejtorit te pergjithshem.

Mbledhjet e keshillit mbikqyrese thirren nga kryetari dhe, ne mungese te tij, nga anetaret e tjere te ketij keshilli.

Kryetari dhe, ne mungese te tij, nejeri nga anetaret duhet te therrese mbledhjen e keshillit brenda 15 ditesh kur nje e treta e anetareve te keshillit i paraqitin atij nje kerkese te arsyetuar per kete. Neqoftese kerkeses nuk i jepet rruge autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes te keshillit mbikqyres duke treguar rendin e dites te mbledhjes.

Mbledhjet e keshillit te mbikqyresdrejtuesve mbahen ne seline e shoqerise, ose ne nje vend tjeter te treguar ne thirrje.

Si rregull thirrja e mbledhjes duhet t'u dergohet anetareve te keshillit tre dite perpara me leter, telegram ose forme tjeter eshkruar komunikimi.

Çdo thirrje duhet te permbaje çeshtjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga kryetari dhe, ne mungese te tij, nga anetari me moshe me te madhe.

Neni 19.

Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli merr vendime te vlefshme kur ne mbledhjen e tij jane te pranishem me shume se gjysma e anetareve ne funksion.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. One stamp includes the date '19' and the text 'Shoqerimi 98'.

Çdo anetar i keshillit mund t'i jape mandat nje anetari tjetër për ta përfaqësuar në mbledhjen e keshillit. Çdo anetar mund të jape vetëm një mandat për të njëjten mbledhje. Anetari i përfaqësuar nuk merret parasysh në llogaritjen e quorumit të anetareve të pranishëm, siç përcaktohet në paragrafin e parë.

Vendimet merren me shumicën e votave të anetareve të pranishëm ose të përfaqësuar. Çdo anetar i keshillit ka vetëm një votë dhe nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anetar tjetër.

Megjithatë kur keshilli mbikqyres është mbledhur për të vendosur mbi një projekt të shitjes së aksioneve një të treti joaksionar në kushtet e parashikuara në nenin 11 të këtij statuti, vendimi i miratimit merret me shumicën e tre të katertave të votave të anetareve të pranishëm ose të përfaqësuar. Neqoftesë shitesi i aksioneve është anetar i keshillit të drejtuesve ai nuk merr pjesë në votim.

Në rast votash të barabarta ajo e kryetarit të seances është përcaktuese.

Neni 20

Dokumentimi i mbledhjeve dhe i vendimeve

Keshilli i mbikqyres mban një libër të pranishëm, i cili firmoset nga anetarët pjesëmarrës në mbledhje.

Justifikimi i numrit të anetareve në funksion dhe i emerimit të tyre provohet në mënyrë të vlefshme ndaj të tjerëve vetëm nga tregimi në proces verbalin e çdo mbledhje të emrave të anetareve të pranishëm, të përfaqësuar ose të munguar.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me anë të procesverbaleve të mbajtura në një libër të posaçëm (protokoll), i numëruar dhe i vëlosur, që mbahet në selinë qendrore të shoqërisë në të cilin tregohen, veç të tjerash, anetarët e pranishëm, të përfaqësuar dhe të munguar si dhe çdo person tjetër që ka asistuar në mbledhjen e keshillit, të prishtit ose pjesërisht.

Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including a date stamp '11' and a signature 'Stojanovic'.

Procesverbalet firmosen nga kryetari i seances dhe te pakten nga nje anetar i keshillit.

Neni 21.

Kompetencat e keshillit mbikqyres

Keshilli i mbikqyres ushtron ato kompetenca te cilat jane te parashikuara ne ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", seksioni i shoqerive anonime, me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe ky statut ia kane rezervuar asamblese se pergjithshme te aksionereve ose drejtorit te pergjitheshem

Aktet dhe operacionet e renditura me poshte jane ne kompetence vetem te keshillit mbikqyres:

1. Miratimi i rregulloreve te brendshme te shoqerise qe percaktojne:
 - a) strukturen e organizimit dhe te administrimit te shoqerise, duke perfshire edhe njesite funksionale dhe administrative te saj, pozicionet mbikeqyrese dhe marredheniet raportuese.
 - b) detyrat e çdo drejtori departamenti dhe te njesive qe ai drejton e mbikqyr.
 - c) funksionet e komitetit te kontrollit te brendshem dhe te komiteve te tjera te brendshme te ngritura nga keshilli i drejtuesve.
2. Miratimi dhe mbikqyrja e zbatimit te politikës se shoqerise per :
 - a) Llojet, kushtet dhe afatet e policave te sigurimit.
 - b) kushtet dhe kriteret sipas te cilave shoqeria mund te negocioje me institucione financiare te tjera, vendas apo te huaja, per te marrë hua si dhe kufijte e huamarrjes.
 - c) Zgjerimin e veprimtarise se shoqerise produkte te reja brenda kufijve te caktuar ne licensen e leshuar nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are two signatures, one of which appears to be 'S. P. ...'. In the center, there is a large, stylized signature. To its right, there is a stamp that reads 'Shoqeria' and '1998'. Below this stamp, there is another signature. On the far right, there is a signature with the number '12' written above it. The signatures are in various colors, including black and blue ink.

3. Miratimi i numrit te pergjithshem te personelit te shoqerise, i kriterëve te marrjes ne pune te personelit teknik, i tabelave te pagave dhe i kriterëve per dhenien e shperblimeve suplementare.
- 4) Pergatitja dhe paraqitja per shqyrtim ne mbledhjen e pergjithshme te aksionereve te gjendjeve financiare vjetore dhe te raportit te veprimtarise.
5. Thirrja e asamblese se pergjithshme sa here qe kjo eshte e nevojshme dhe ne mbyllje te çdo viti financiar per te miratuar gjendjet financiare vjetore.

Neni 22

Informimi i anetareve te keshillit

Çdo anetar i keshillit mbikqyres ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga Drejtoria e Pergjithshme e shoqerise informacion per çeshtje te natyres administrative; teknike dhe financiare qe i mundesojne atij te verifikoje dhe gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesisht i qarte per vendimet qe duhen marre apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Kryetari i keshillit te drejtuesve ka pergjegjesine per t'i vene anetaret e keshillit ne gjendje qe te marrin informacionet e kerkuara.

Çdo anetar i keshillit mbikqyres duhet te njoftohet personalisht per mbledhjet e keshillit dhe t'i vihen ne dispozicion ne seline e shoqerise apo t'i dergohen bashke me thirrjen dokumentet dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

Shoqeria nuk eshte e detyruar ti jape anetareve te keshillit te drejtuesve kopjo te proces verbaleve te vendimeve te keshillit, por çdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne seline e saj.

Mosnjohja e te drejtave te çdo anetari te keshillit per informacionet e mesiperme dhe mos thirrja ne mbledhjen e keshillit sjell pavlefshmerine e vendimeve te keshillit.



The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the right side, there is a circular stamp with the number '13' inside. Below it, there is a signature that appears to be 'Fetele' and another signature that looks like 'Stojanovic'. There are also some other illegible signatures and marks.

Neni 23.

Pergjegjesite e anetareve te keshillit mbikqyres

Anetaret e keshillit mbikqyres mbajne pergjegjesi civile solidarisht dhe individualisht, sipas rastit, ndaj te treteve dhe ndaj shoqerise per shkeljet e dispozitave ligjore ose te rregullimeve te zbatueshme per veprimtarine e shoqerise, per shkelje te statutit si dhe per gabimet e bera ne administrimin e shoqerise per shkak te vendimeve te tyre.

Pergjegjesia penale e anetareve te keshillit te mbikqyres percaktohet ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 24.


Shperblimi i vecante per pjesemarrjen ne keshill dhe shperblimet e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mund t'u caktojte anetareve te keshillit te drejtuesve si shperblim per pjesemarrjen ne keshill nje shume vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Shuma e shperblimit te caktuar per keshillin shperndahet midis anetareve te tij nga vete keshilli mbikqyres.

Keshilli mbikqyres mund te caktojte shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkohen misione apo u jepen mandate per sherbime apo detyra te caktuara.

Shperblimet e vecanta dhe te jashtezakonshme perballohen nga llogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzimet e saj.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. The stamps include the date '14' and the year '98'. There are several illegible signatures and a large, stylized signature on the right side.

Seksioni 2

Drejtori i pergjithshem, dhe drejtuesit teknike

Neni 25.

Drejtori i pergjithshem

Drejtori i pare i Pergjithshem i shoqerise emerohet nga Asambleja e Aksionereve. Si drejtor i pare emerohet Lavdim Avllaj. Mandati i funksionit te tij eshte 2 vjet.

Drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marrredheniet me te tretet me kompetenca te plota ne kufijte e objektit te saj, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia ka caktuar shprehimisht asamblese se pergjithshme te aksionereve dhe te kompetencave te specifikuara te keshillit mbikqyres

Çdo kufizim i kompetencave te drejtorit te pergjithshem me vendim te keshillit mbikqyres eshte pa efekt ndaj te treteve.

Drejtori i pergjithshem mund t'i delegoje nje pjese te kompetencave te tij tek persona te tjere. Ne kete rast ai mban pergjegjesi vete perara shoqerise per demet qe mund t'i kete sajle asaj nga veprimi i personit te cilit i jane dekleguar kompetencat sipas parashikimeve te ketij paragrafi.

Neni 26.

Zevendesimi i perkoheshem i drejtorit te pergjithshem

Keshilli i Mbikqyres nje anetar i keshillit, qe te zevendesoje perkohesisht ne te gjitha funksionet e drejtorit te pergjithshem ne rastet kur ky i fundit:

1. per arsyje semundje te zgjatur ose nje ngjarje tjeter te papritur pengohet per te ushtruar funksionet e tij,
jep doreheqjen ose vdes dhe nuk eshte e mundur te behet menjehere emerimi i drejtorit te ri.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. From left to right, there are three distinct signatures. In the center, there is a large, stylized signature that appears to be 'L. Avllaj'. To its right, there is a signature that reads 'L. Avllaj' with the date '15.05.98' written below it. Further right, there is another signature, possibly 'Shoja', with the number '15' written above it. At the bottom right, there is a large, illegible signature.

Neni 27.

Drejtoret teknike

Drejtoret teknike jane te punesuar te shoqerise emerohen nga drejtori i pergjithshem, i cili percakton edhe funksionet e tyre, ne pajtim me rregulloren e shoqerise te miratuar nga keshilli mbikqyres.

Drejtoret teknike nuk kane asnje kompetence per ta angazhuar shoqerine ne te treteve, pervec rastit kur drejtori i pergjithshem u ka deleguar atyre me mandat nje pjese te kompetencave te tij.

Neni 28

Kompetencat e Drejtorit te pergjithshem

Drejtori i Pergjithshem u shtron te gjitha kompetencat qe nuk i ka Asamabaeja e Pergjitheshme e Ajsionereve, si dhe Keshilli Mbikqyres, si dhe eshte i vetemi person qe perfaqseon personalitetin juridik te shoqerise.

Neni 29

Detyrimi per te ruajtur sekretin

Anetaret e keshillit te Mbikqyres, drejtori i pergjithshem si dhe te gjithe personat e punesuar ne shoqeri dhe agjente te saj, jane te detyruar te ruajne fshehtesine e çdo informacioni qe marrin gjate kryerjes se detyrave ne shoqeri dhe te mos e perdorin ate per perfitime personale apo per te trete, si gjate kohes qe jane ne funksion ashtu edhe pas largimit te tyre.

Keshilli i mbikqyres miraton rregulla e procedura me te hollesishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga personat e permendur me siper si dhe per komunikimin e informacioneve autoriteteve apo organeve te cileve kjo e drejte u eshte njohur me ligj.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. From left to right, there are: a signature that appears to be 'I. Princi', another signature, a large stylized signature, a signature that includes the name 'Radaj' and the year '98', and a signature that appears to be 'Stojan'. There are also some illegible stamps and scribbles.

Seksioni 3
Kontrollori i pavarur
(Eksperti kontabel i Autorizuar)

Neni 30

Emerimi dhe shperblimi



Asambleja e pergjithshme e aksionereve cakton nje kontrollor te pavarur dhe nje ndihmes te tij, te zgjedhur te dy nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ne caktimin e kontrolloreve te pavarur mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtuesmerite e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar.

Shperblimi i kontrolloreve te pavarur caktohet nga asambleja e aksioneve dhe perballohet nga shoqeria.

Neni 31

Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e kontrolloreve te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare", dhe nga aktet e tjera ne fuqi qe rregullojne kete profesion.

Asambleja e aksionereve mund t'u kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve te posacme per ceshtje ne interes te shoqerise.

17

KAPITULLI IV

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

Neni 32

Natyra e asambleve dhe karakteri detyrues i vendimeve

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme ose te jashtezakonshme sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre. Eksperti Kontabec i Shoqerise duhet jete Fjaltri Duri.

Çdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionareve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithë aksionaret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

Neni 33.

Thirrja dhe vendi i asamblese.

Asamblete e pergjithshme thirren nga keshilli mbikqyres. Ato mund te thirren, gjithashtu, nga kontrollori i pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata dhe, kur eshte rasti, nga likuiduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionareve behet me ane te njoftimit qe i dergohet cdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.


The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are two signatures, one of which appears to be 'M. X. L.'. In the center, there is a diagonal stamp. On the right, there is a large signature, a smaller signature, and a stamp that reads 'Shoqerise' and '18'.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionareve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhjes se asamblese dhe duhet te permbaje ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, natyrën e asamblese, dhe rendin e dites.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i kerkuar mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejta forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes te mbledhjes se dyte rikujtojne datën dhe rendin e dites.

Neni 34

Rendi i dites




Rendi i dites te mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori i thirrjes. Nje ose disa aksionare qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te kapitalit themeltar te shoqerise kane te drejte te kerkojne qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e shoqerise te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe aresyet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses te kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi i dyte i ketij neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqeruese duhet te mberijne ne seline e shoqerise te pakten 5 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dite. Megjithate ajo mundet, ne cdo rrethane, te shkarkoje nje ose disa anetare te keshillit mbikqyres, drejtorin e pergjithshem, dhe te beje zevendesimin e tyre.


Rendi i dites te mbledhjes se asamblese nuk mund te ndryshohet me nje njoftim te dyte.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page, including a date stamp '1998' and a signature 'Hoxham'.

Neni 35.

Hyrja ne asamble



Çdo aksioner, pavaresisht nga numri i aksioneve qe zoteron, ka te drejte te asistojë ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin e aksionerit si dhe te rregjistrimit te tij ne regjistrin e aksioneve te shoqerise.

Çdo aksioner mund te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese vetem nga bashkeshorti ose nga nje aksioner tjetër. Per kete qellim perfaqesuesi duhet te pajiset nga aksioneri me mandat te posacem, ne kushtet e parashikuara nga ligji.

Neni 36

Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces verbalet


Per çdo mbledhje te asamblese mbahet nje flete-pranie e cila permban treguesit qe provojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flete-prania firmoset ne ane nga aksioneri ose, kur eshte rasti, nga perfaqesuesi i tij dhe vertetohet per saktesine e saj nga komisioni vevzhgues i mbledhjes.

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari i saj, i cili eshte i zgjedhshem ne cdo mbledhje nga vete aksioneret me perqindjen e thjeshte te votave te aaksionereve pjesemarres ne mbledhje.

Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga kontrollori i pavarur, mandatmbajtësi i caktuar nga gjykata apo, likuiduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Per çdo mbledhje te asamblese hartohet nje proces verbal i cili permban:

- daten dhe vendin e mbledhjes
- menyren e thirrjes
- rendin e dites





- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vezhgimit
- numri i aksioneve qe marrin pjese ne votim
- quorumi i arritur
- permendjen e dokumenteve dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje
- nje permbledhje te debateve
- tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte nga aksioneret.
- rezultatet e votimeve

Proces verbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje regjister te posacem, i numertuar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e shoqerise.

Neni 37.

Quorumi, votimi, numri i votave

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise.

E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Çdo aksion i kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote. Megjithate kur aksionet e shoqerise zoterohen nga nje ose disa persona juridike ne te cilet shoqeria ka, drejteperdrejte ose terthorazi, kontrollin e drejta e votes te aksioneve te personave juridike nuk mund te jete me shume se 10 per qind te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese.

Votimi kryhet e vecante per çdo çeshtje apo vendim.

Neni 38.

Asamblete e pergjithshme te zakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur.


Ajo ka, midis te tjerash, kompetencat qe vijojne:

- te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise.
- te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- te miratoje, ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe i shtruar per miratim;
- te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
- te emeroje dhe shkarkoje anetaret e keshillit te mbikqyres.
- te emeroje kontrollorin ose kontrolloret e pavarur te llogarive (Ekspertet kontabel te autorizuar).
- te miratoje ose te mos miratoje emerimet e anetareve te keshillit te mbikqyres te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme.
- te miratoje pagen e drejtorit te pergjithshem dhe raportet e pagave per kategorite e tjera te personelit te shoqerise, si dhe shperblimet suplementare qe mund te jepen per pune ose rezultate te mira.
- te caktoj shperblimin e vecante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per keshillin mbikqyrese.
- te vendose per raportin e kontrollorit te pavarur lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit mbikqyrs.

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statudit.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet per mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.



Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. One stamp is dated '18 venediqe 98'. There are several illegible signatures and a large handwritten mark.

Neni 39.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionereve pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky qorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 40.

Venia ne dispozicion te aksionereve te dokumenteve dhe informacioneve

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrjen per mbledhje.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are several overlapping signatures. In the center, there is a large, stylized signature. To the right, there is a signature with the date '23' written above it. Below the signatures, there are some faint, illegible markings and what appears to be a stamp or official mark.

KAPITULLI V KONTABILITETI, GJENDJET FINANCIARE, CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 41.

Kontabiliteti, inventari, gjendjet financiare

Shoqeria mban kontabilitetin e saj ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin" dhe me rregullimet kontabel specifike per shoqerite e sigurimeve.

Ajo kryen nje here ne 12 muaj inventarizimin e aktiveve dhe te pasiveve te saj, perpara se te pergatite gjendjet financiare vjetore.

Ne mbyllje te cdo viti financiar, por jo me vone se 3 muaj nga data e mbylljes se vitit, shoqeria pergatit gjendjet financiare vjetore sipas rregullave te caktuara per kete qellim.

Viti financiar per te cilin pergatiten dhe publikohen gjendjet financiare te shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Neni 42.

Rezultati financiar

Rezultati financiar i shoqerises percaktohet ne mbyllje te cdo viti si diference midis te ardhurave dhe shpenzimet pasi te zbriten, gjithashtu, amortizimet dhe shumat e provizioneve per zhvleresime dhe per rreziqe e shpenzime, perjashtuar shumat e rezervave teknike te krijuara ne peruthje me reregullat per shoqerite e sigurimeve.

Fitimi neto i shoqerise percaktohet pasi te zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur ne menyre te perqendruar per shoqerine ne teresi.

Handwritten signatures and stamps at the bottom of the page. One stamp is dated 1/24. There are several illegible signatures and a stamp that appears to say 'Shoqëria' and '1/24'.

Neni 43

Caktimi(ndarja) e fitimit neto.

Fitimi neto i shoqerise caktohet per qellimet qe vijojne :

1. Per rezerven e domosdoshme te parashikuar nga neni 2,3 i ligjit "Per shoqerite tregtare"
2. Per rezervat e detyrueshme te tjera te kapitaleve te veta
3. Per dividente.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose heqjen e nje pjese te fitimeve per krijimin e rezervave te lira per t'u perdorur ne interes te zhvillimit te shoqerise.

Fitimet e shoqerise nuk mund te caktohen per shperblime apo perfitime te tjera te personelit, per sponsorizime apo dhurime dhe as per ndonje qellim tjetër qe ka natyre shpenzimi dhe hyn ne koston e aktivitetit te shoqerise.

Shoqria eshte e detyruar te krijojë edhe rezervat e detyrueshme ne peruthje me ligjin Nr. 8081, date 7.03.1996 "per sigurimet dhe risigurimet" dhe akteve te tjera te dala nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve.

Neni 44

Fitimi i shperndashem-Dividendet

Fitimi i shperndashem si dividend perbehet nga fitimi neto i vitit financiar i pakesuar me humbjet e mbartura dhe me shumat e hequra per rezervat ne zbatim te ligjit dhe te statutit dhe i shtuar nga fitimet e mbartura.

Fitimi i shperndashem ndahet midis te gjithe aksionereve ne perpjestim me numrin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre.

Shoqeria nuk mund te shperndaje dividente neqoftese kapitalet e veta jane ose do te beheshin, si rrjedhoje e shperndarjes, me te vogla nga shuma e kerkuar nga ligji.

The bottom of the page contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there are two distinct signatures. In the center, there is a large, stylized signature. To the right, there is a signature that appears to be 'Hoja' with the number '25' written below it. A date stamp '12.03.96' is visible in the middle of the signatures.

Neni 45.

Humbjet dhe mbartja e tyre

Pas miratimit te gjendjeve financiare vjetore nga asambleja e pergjithshme, humbja e rezultuar ne nje vit financiar mbartet ne vitet pasues per t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri ne shuarjen e humbjes.



KAPITULLI VI

DEGET E SHOQERISE

Neni 46

Statusi i deges

Dega e shoqerise eshte njesia baze organizative e saj dhe varet nga Drejtoria e Pergjithshme.

Dega e shoqerises krijohet ne baze rrethi ose rajoni dhe ka ne vartesi agjenci dhe zyra te shoqerise.

Neni 47.

Drejtimi i deges se shoqerise

Drejtimi dhe administrimi i deges ushtrohet nga drejtori i saj, i cili pergjigjet per gjithe veprimtarine e deges ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi qe veprojne ne fushen e sigurimeve, udhezimet e Drejtorise se Pergjithshme dhe dispozitat te ketij statuti.

Drejtori i deges ne perputhje me strukturen organizative dhe numrin e punonjesve te miratuar, emeron e shkarkon punonjesit dhe percakton pagat e tyre mujore, ne perputhje me tabelen e pagave te miratuar nga Keshilli i Mbikqyres.

Neni 48

Raportimet e deges

Dega i dergon Drejtorise se Pergjithshme, ne afatet e caktuara prej saj, bilancin me relacionin shoqerues dhe evidencat e tjera statistikore, si dhe çdo informacion tjetër qe i kerkoet.



KAPITULLI VII

KUJDESTARI DHE LIKUIDIMI

Neni 58.

Dispozitat e zbatueshme

Per kujdestarine si dhe per likujdimin e shoqerise ne rast prishjeje ose falimentimi zbatohen dispozitat e ligjit "Per sigurimet dhe rsigurimet", rregullat e percaktuara per kete qellim nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve si dhe te ligjive te tjera qe rregullojne keto gjendje.

AKSIONERET

1. BEHAR SHEHU

Behar Shehu

3. DOD DOÇI

Dod Doçi

5. FATMIR THANA

Fatmir Thana

7. IDAJET KUKA

Idajet Kuka

9. MADALENA XHARA

Madalena Xhara

2. SHPETIM PRODANI

Shpetim Prodani

4. THANAS KOSTAQI

Thanas Kostaqi

6. HYSEN TEPELENA

Hysen Tepele

8. VLADIMIR BURILL

Vladimir Burill

10. LAVDI AVLLAJ

Lavdi Avllaj

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE "SIGURI E MADHE"

SH.A (SIGMA" SH.A)



Ne te nenshkruarit.

1. **Behar Shehu**, i biri i Kamberit , lindur ne Diber, me date 21 mars 1996, dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Irfan Tomini" pallatet e INSIG-ut, me numer pasaporte 0433393,
2. **Shpetim Prodani**, i biri i Muhametit, lindur ne Durres, me date 2 nentor 1950, dhe banues ne Durres ne adresen Lagjia nr.2, Rruga "Aleksander Goga" Ap 55/2, me numer pasaporte 0539505,
3. **Dod Doçi**, i biri i Lleshit, lindur ne Lure te rrethit Diber me date 10 Dhjetor 1956, dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Vaso Pasha", Pall.15/1, Ap. 3, me numer pasaporte 0063664,
4. **Thanas Kostaqi**, i biri i Vangjlit, lindur ne Gjirokaster me date 7 qershor 1951, dhe banues ne Gjirokaster ne adresen Blloku i furrave, me leternjoftimin numer UG 277708,
5. **Fatmir Thana**, i biri i Nuredinit, lindur ne Gjirokaster me date 20 janar 1939, dhe banues ne Tirane ne Adresen Lagjia "Ali Demi", Pall.266/1 Ap.8 me pasorten numer 0353233,
6. **Hysen Tepelena**, i biri i Fehmiut, lindur ne Durres me date 25.11.1951, dhe banues ne Durres ne adresen Lagjia nr. 3 Rruga "E. Vgjia" Nr.1 me leternjoftimin Nr. UG 477490
7. **Idajet Kuka**, i biri i Nexhipit, lindur ne Fier me date 20.10.1953, banues ne Fier ne adresen Pall. INSIG, me leternjoftimin nr. EV 439534,
8. **Vladimir Burill**, i biri i Nikolles, lindur ne Shkoder, me date 13 korrik 1944, dhe banues ne Shkoder ne adresen Lagjia nr.3 Rruga "Skanderbeg" Pallatet "Ara e Pashes", me pasorten nr. 0314997,
9. **Madlena Xhara**, e bija e Nikos, lindur ne Korce me date 11 janar 1952 dhe banuese ne Korce ne adresen Lagjia 18, rruga "Maqo Naçi " Nr. 44 me leternjoftimin Nr. ~~029~~ **AZ 029 838** perf. me *prekshen*

Shkodri 98

[Signature]

[Signature]

[Signature]
[Signature]
[Signature]

10. Lavdi Avllaj, i biri i Faikut, lindur ne Kruje me date 13 nentor 1960, dhe banues ne Tirane, Rruga "Irfan Tomini" Pallati C 2/1 me pasaporten nr. 0260781

te mbledhur sot me date _____ 1998 vendosem te themelojme shoqerine anonime sipas parashikimeve te ketij akti thmemelimi dhe statutit bashkangjitur. Per kete arsye ne vendosem sa me poshte:

1. Te themelojme shoqerine anonime me emrin "SIGURIA E MADHE" sh.a. Emertimi i shkurtuar i shoqerise do te jete "SIGMA" sh.a.-----

2. Ne te gjitha aktet qe do te nxjerre shoqeria kundrejtuar te treteve si dhe ne gjitha akte e brendeshme te saj do te shneohet detyrimisht emri "SIGMA" Sh.a dhe shuma e kapitalit thmeltar te saj.-----

3. Shoqeria" do te kete per objekt veprimtarie te saj sigurimin nga demet dhe risigurimet, ne perputhje me ligjin Nr.8081, date 7.03.1996 "Per sigurimet dhe risigurimet" si dhe cdo objekt tjetër te lejuar nga legjislacioni ne fuqi dhe qe nuk vjen ne kundërshtim me ligjin e mesiperm dhe rregullat e percaktuara per kete qellim nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve. Shoqeria nuk do te kete per objekt te veprimtarise se saj sigurimin e jetes.-----


4. Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne adresen Rruga SHESH I "WILSONI" PALLATI I RI 3-KATEDA. Selia e shoqerise mund te ndryshoje ne perputhje me rregullat e vendosura nga Asambleja per kete qellim ne statutin e saj.-----

5. Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 30.000.000 (tridhjetemilion).leke.-----

Ai eshte i ndare ne 30.000 (tridhjetemije) aksione nominative te themeluesve te shoqerise te cilet jane te se njejtës kategori me vlere nominale prej 1.000 (njemije) leke per çdo aksion.-----

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri ne 30.000 perfshire numrin e fundit te aksionit.-----

Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si me poshte:-----

The block contains several handwritten signatures and stamps. On the left, there is a signature that appears to be 'Arrodani 98' with a date '10-22-98' written below it. In the center and right, there are several other signatures, some of which are more stylized and difficult to read. A circular stamp is visible on the right side, partially overlapping the text. The number '30' is written in the bottom right corner of the signature area.

Emri Mbiemri	perqindja	Nr. I aksioneve	Vlera ne leke-----
1. Behar Shehu	24 %	7.200	7.200.000-----
2. Shpetim Prodani	21 %	6.300	6.300.000-----
3. Dod Doçi	21 %	6.300	6.300.000-----
4. Thanas Kostaqi	10 %	3.000	3.000.000-----
5. Fatmir Thana	8%	2.400	2.400.000-----
6. Hysen Tepelena	4 %	1.200	1.200.000-----
Idajet Kuka	4 %	1.200	1.200.000-----
Vladimir Burill	3 %	900	900.000-----
Madlena Xhara	3 %	900	900.000-----
10. Lavdi Avllaj	2 %	600	600.000-----

6. Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Keshilli Mbikqyres,
- Drejtori i Pergjithshem.

7. Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga tre vete, te cilet jane caktuar si me poshte nga mbledhja themeluese e shoqerise:

- ⇒ Dod Doçi Kryetar
- ⇒ Fatmir Thana Anetar
- ⇒ Xhemali Shehu Anetar.

8. Afati i ushtrimit te veprimtarise se ketij keshilli eshte sipas stautit te shoqerise.

9. Drejtor i Pergjithshem i shoqerise i caktuar ne mbledhjen e pare themeluese te saj do te jete Lavdi Avllaj

10. Afati i ushtrimit te funksioneve te tij dhe kompetencat e tij jane sipas stautit te shoqerise.

11. Shoqeria autorizon Drejtorin e Pergjithshemte saj te kryeje veprimet e rregjstrimit te shoqerise ne gjykate dhe per te paraqitur kerkesen dhe per te perfaqesuar shoqerine ne procesin e licensimit te saj nga Komisioni i mbikqyrjes se Sigurimeve.

[Handwritten signatures and stamps]

31

12. Kapitali thmeltar i aksionereve te shoqerise do te derdhet ne Banken e Tiranës, dhe ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqerise te vertetoje sipas ekstraktit bankar derdhjet e kapitalit nga secili aksioner, si dhe tu japë vertetime se cilat për shumën e derdhur. Kapitali thmeltar në momentin e nëshkrimit të akteve të thmeltimit të shoqerise është sa 1/2 e tij, dhe vertetohet se ai është derdhur rregullisht nga aksionerët sipas dokumentacionit ngjitur kësaj akti themelimi.

13. Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degëve apo filialeve të saj do të përbehen në përputhje me dispozitat e statutit.

14. Shoqeria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar duke filluar nga momenti i marrjes së licencës për ushtrim veprimtarie nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve. Në rast se kjo licencë refuzohet, atëherë Drejtori i Shoqerise njofton për këtë qëllim brenda 15 ditëve aksionerët, të cilët do të vendosin për shpërndarjen e shumave të vendosura prej tyre në kapitalin thmeltar, duke caktuar për këtë qëllim një likuidator, i cili merr përsypsh shpenzimet që ka bërë shoqeria deri në këtë moment.

15. Dispozita me të hollësishme për shoqerine caktohen në statutin e saj.

AKSIONERET

1. BEHAR SHEHU

Behar Shehu

3. DOD DOÇI

Dod Doçi

5. FATMIR THANA

Fatmir Thana

7. IDAJET KUKA

Idajet Kuka

9. MADALENA KHARA

Madalena Khara

2. SHPETIM PRODANI

Shpetim Prodan

4. THANAS KOSTAQI

Thanas Kostaqi

6. HYSEN TEPELENA

Hysen Tepele

8. VLADIMIR BURILL

Vladimir Burill

10. LAVDI AVLLAJ

Lavdi Avllaj